



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 152

Tiranë – E enjte, 21 gusht 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 3, datë 13.8.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 27.6.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar 20711
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 20, datë 13.8.2025	Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar..... 20712
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 804, datë 14.8.2025	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar..... 20726



UDHËZIM
Nr. 3, datë 13.8.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 27.6.2022,
“PËR KUALIFIKIMIN E VAZHDUAR
PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE
TË KULTURËS PROFESIONALE NË
ARSIMIN DHE FORMIMIN
PROFESIONAL”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të pikës 1, të nenit 70, të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 21, datë 27.6.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në tekst togfjalëshi “Komisioni i akreditimit të programeve dhe trajnimeve (KAPI)” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)”.

2. Neni 3, pika 1, shkronja “b”, ndryshohet si më poshtë:

“b) Të kryejë çdo vit, të paktën 18 orë (1 kredit) trajnime, të akredituara nga AKAFPK-ja ose 18 orë (10 kredite) trajnime të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe të njohura nga AKAFPK-ja”.

3. Në nenin 4, pika 2, bëhen ndryshimi si më poshtë:

“a) Në shkronjën “a”, togfjalëshi “5 vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “3 vjet”;

“b) Në shkronjën “b”, togfjalëshi “10 vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “8 vjet”;

“c) Në shkronjën “c”, togfjalëshi “20 vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “15 vjet”, si dhe

togfjalëshi “10 vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “7 vjet”.

4. Në nenin 4, pika 3, riformulohet si më poshtë vijon:

“Mësimdhënësit e kulturës profesionale, të cilët plotësojnë kriteret për fitimin e një kategorie kualifikimi më të lartë se ajo që zotërojnë, pavarësisht vjetërsisë së punës në arsim, kandidojnë për kategorinë më të ulët të kualifikimit që nuk e kanë përfituar, paraqesin në drejtorinë e ofruesit të AFP-së përkatëse, në periudhën 1–31 tetor, kërkesë me shkrim për të kryer kualifikimin përkatës, në vitin pasardhës.”.

5. Në nenin 5, pika 2 togfjalëshi “pikës 6 të nenit”, zëvendësohet me togfjalëshin “pikës 6 të nenit 4”.

6. Në nenin 5, pika 3, shkronja “b”, ndryshohet si më poshtë:

“b) Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga AKAFPK-ja, me kreditet e fituara (të paktën 3 kredite) ose të akredituara nga ASCAP-i (të paktën 30 kredite) për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe (të paktën 5 kredite) të akredituara nga AKAFPK-ja, ose (të paktën 50 kredite) të akredituara nga ASCAP-i, për kategorinë “Mësues specialist”, si dhe (të paktën 7 kredite) të akredituara nga AKAFPK-ja, ose (të paktën 70 kredite) të akredituara nga ASCAP-i për kategorinë “Mësues mjeshtër”, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3”.

7. Në nenin 5, pika 3, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me përmbajtje si më poshtë:

“dh) Certifikatën e kategorisë (shkallës) së kualifikimit të fundit që zotëron për mësimdhënësit kandidatë për kategoritë “Mësues specialist” dhe “Mësues mjeshtër”.”.

8. Në nenin 5, pika 3, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “ë”, me përmbajtje si më poshtë:

“ë) Vlerësimin e performancës së vitit të fundit nga drejtuesi i ofruesit të AFP-së. Dokumenti i vlerësimit duhet të jetë i vultur dhe i firmosur nga drejtori i ofruesit.”.

9. Në nenin 5, pika 3, shkronja “f”, togfjalëshi “Vërtetimin, nëse ka kryer ...” zëvendësohet me togfjalëshin “Vërtetimin e kryerjes ...”.

10. Në nenin 5, pika 5, pas togfjalëshit “shkronjat “a”, “b”, “d” shtohen shkronjat “... “dh”, “ë” dhe “f””.

11. Në nenin 8, pas pikës 15 shtohet pika 16, me përmbajtje si më poshtë:



“16. AKAFP-ja, për procedurat e akreditimit të trajnimeve, nxjerr një udhëzues të posaçëm të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AKAFPK-së.”.

12. Në nenin 17 togfjalëshi “... Ministria e Financave dhe Ekonomisë ...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ...”.

13. Në tabelën 2, të shtojcës 2 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) rreshti i tretë, i kolonës së parë, ndryshohet si vijon:

“Trajnime profesionale në fushën / drejtimin / profilin përkatës”;

b) rreshti i tretë, i kolonës së parë, ndryshohet si vijon:

“Të paktën një certifikatë të fituar në tri vitet e fundit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 20, datë 13.8.2025

PËR VITIN SHKOLLOR 2025–2026 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave dhe i veprimtarive që ndërmarrin institucionet e

sistemit arsimor parauniversitar gjatë vitit shkollor 2025–2026.

Neni 2

Regjistrimi i nxënësve dhe pajisja me tekste shkollore

1. Regjistrimet e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar (IAP) të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi që përcakton moshën dhe dokumentacionin e nevojshëm.

2. Drejtoritë e IAP-ve të afishojnë në vend të dukshëm listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit për çdo klasë, vendi ku do të shpërndahen tekstet, si dhe periudha e shpërndarjes sipas një grafiku për çdo klasë.

3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e IAP-ve dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:

a) procesin e shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit para fillimit të procesit mësimor;

b) procesin e pajisjes me tekste shkollore në përdorim falas për klasat I–IX të arsimit bazë, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) të raportojë zyrtarisht në MAS për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore, me fokus kategoritë e veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Ndalimi i përdorimit të telefonit celular

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të marrin masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për ndalimin e përdorimit të telefonit celular në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare.

2. Drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar të marrë masa për të përfshirë në rregulloren e brendshme mënyrën e organizimit dhe marrjen e masave shtesë për zbatimin korrekt të akteve nënligjore përkatëse.



Neni 4

Shërbimi psikosocial dhe oficeri i sigurisë

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psikosocial (SHPS), në zbatim të urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit nga shërbimi psikosocial”, i ndryshuar.

2. DRAP/ZVAP-të të monitorojnë realizimin e planit të punës së njërive të ShPS-së dhe të raportojnë në AKAP në muajt janar dhe qershor 2026, për realizimin e tij. AKAP-i të raportojë në MAS në muajt shkurt dhe korrik 2026.

3. Puna e punonjësve të SHPS-së në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në:

a) “Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psikosocial shkollor”, miratuar në qershor 2022;

b) udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psikosocial shkollor (rishikuar);

c) parimet për etikën profesionale të shërbimit psikosocial shkollor (rishikuar).

4. Puna e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në:

a) udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë (rishikuar);

b) parimet për etikën profesionale të oficerëve të sigurisë në shkolla.

KREU II

**VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE**

Neni 5

Arsimi parashkollor

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

a) Marrjen e masave për krijimin dhe përmirësimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të institucioneve arsimore parashkollore të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, që të mundësojnë zhvillimin dhe edukimin cilësor të fëmijëve;

b) Marrjen e masave për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve 3–6 vjeç në arsimin parashkollor.

c) Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit të institucioneve arsimore parashkollore me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me komunitetin, për krijimin e një modeli motivues të sjelljes së fëmijëve, mësuesve dhe prindërve në mjediset e institucioneve arsimore parashkollore dhe jashtë tyre.

ç) Regjistrimin me përparësi në institucionet arsimore parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.) dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

d) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve (3–6 vjeç) me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.

dh) Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollor në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara;

e) Pajisjen e fëmijëve që përfundojnë grupin e tretë të arsimit parashkollor ose klasën përgatitore dhe kanë moshën për të ndjekur klasën e parë të arsimit bazë, me vërtetimin e ndjekjes së arsimit parashkollor për grupin përkatës, të nënshkruar nga drejtuesi i institucionit të arsimit parashkollor;

ë) Ngritjen në çdo institucion arsimor parashkollor të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve dhe komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi;

f) Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe nga rrjetet profesionale të temave të mëposhtme:

i. standardet e zhvillimit dhe të nxënës të fëmijëve 3–6 vjeç;

ii. kurrikula me kompetenca dhe planifikimi në arsimin parashkollor;

iii. portofoli i të nxënës;

iv. korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor;

v. standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor;

vi. standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore;

vii. arsimi gjithëpërfshirës;

viii. mësimdhënia me fëmijën në qendër;



ix. ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3–6 vjeç;

x. zhvillimi profesional i mësuesit dhe i drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor, faktor në rritjen e cilësisë së shërbimeve për fëmijët 3–6 vjeç.

Neni 6 Arsimi bazë

DRAP/ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të sigurojnë:

a) Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, që nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të drejtë dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë mes stafit, komunitetit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për krijimin e një modeli motivues të sjelljes së fëmijëve, mësuesve dhe prindërve në mjediset e shkollës dhe jashtë saj;

c) Zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

ç) Zbatimin e planit mësimor për klasën e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, miratuar me urdhrin nr. 203, datë 25.4.2023;

d) Zbatimin e planit mësimor për klasat VI–IX, miratuar me urdhrin nr. 127, datë 1.6.2021, “Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë”,¹ sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

dh) Zbatimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 531, datë 9.9.2022;

e) Zbatimin e planit mësimor për Qendrën Burimore të Nxënësve që nuk Dëgjojnë, të rishikuar, miratuar nga MAS-i, me shkresën nr. 7254/1 prot., datë 10.11.2022, plani mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë;

ë) Zbatimin e planit mësimor për Qendrën Burimore “Ramazan Kabashi”, miratuar me urdhrin

nr. 694, datë 18.11.2022, plani mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë;

f) Zbatimin e planit mësimor për arsimin bazë me kohë të pjesshme, miratuar me urdhrin nr. 284, datë 28.7.2021;

g) Zbatimin e planit mësimor të shkollave speciale miratuar me urdhrin nr. 366, datë 21.9.2021.

gj) Zbatimin në të gjitha shkollat e pajisura me *smartlab* të programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e parë, miratuar me urdhrin nr. 304, datë 10.6.2022;

h) Zbatimin në të gjitha shkollat e pajisura me *smartlab* të programit mësimor të lëndës së TIK-ut për klasën e dytë, të miratuar me shkresën nr. 2608/2 prot., datë 8.5.2023;

i) Zbatimin në të gjitha shkollat e pajisura me *smartlab* të programit mësimor të lëndës së TIK-ut për klasën e tretë, miratuar me urdhrin nr. 267, datë 3.6.2024;

j) Zbatimin e programit mësimor të lëndës së TIK-ut për klasën e katërt në shkollat e mbështetura nga projekti “Element IT”, miratuar me urdhrin nr. 344 prot., datë 21.7.2025, si dhe në shkolla të tjera në të cilat janë ndërtuar laboratorë SMART në kuadër të financimeve të ndryshme dhe me partnerë zhvillimorë të MAS-it;

k) Zbatimin e planit mësimor të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 305, datë 16.6.2023;

l) Zbatimin e planit mësimor të niveleve “Arsim fillor” dhe “Arsimi i mesëm i ulët” të shkollës me status të veçantë “Koreografike”, Tiranë, miratuar me urdhrin nr. 357, datë 23.7.2025;

ll) Zbatimin e urdhrit nr. 463, datë 30.8.2024, “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”;

m) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin/përcaktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi;

n) Zbatimin nga institucionet arsimore të planit të veprimit të hartuar prej tyre (DRAP/ZVAP) për mbështetjen e arsimimit në gjuhën amtare të

¹ Ky urdhër do të zbatohet vetëm për klasat VI–IX, pasi urdhri nr. 203, datë 25.4.2023, “Për miratimin e planit Faqe| 20714

mësimor të arsimit bazë”, i cili ka hyrë në fuqi nga viti shkollor 2023–2024, zbatohet për klasat I–V.



fëmijëve të pakicave kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

n) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të veçanta në institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare;

o) Regjistrimin me përparësi në shkollë të fëmijëve nga shtresat në nevojë, pakica kombëtare, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni, të fëmijëve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore etj.;

p) Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara;

q) Ndjekjen dhe përfundimin e arsimit bazë nga fëmijët romë, sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët;

r) Raportimin në AKAP dhe në MAS brenda afateve dhe kërkesave të të dhënave statistikore në arsimin bazë, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i;

rr) Funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve, mësuesve ndihmës dhe shërbimit psikosocial;

s) Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe të provimeve kombëtare të arsimit bazë, në zbatim të udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse;

sh) Trajnimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të arsimit fillor, gjuhës shqipe, matematikës, shkencave të natyrës e profileve të tjera;

t) Koordinimin dhe realizimin e veprimtarive për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme dhe parandalimin e fenomeneve negative në shkollë, në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 658, datë 23.9.2019, “Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në rast kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij”;

th) Sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme, sipas legjislacionit në fuqi;

u) Zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”, me vendimmarrje të vetë shkollës, në varësi të kushteve dhe specifikave të saj;

v) Koordinimin, në zbatim të Marrëveshjes – e-Twinning NSO AL ndërmjet MAS dhe Komisionit Evropian, për zbatimin e programit *e-twinning*, programit Erasmus+ për arsim dhe edukim;

x) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për parandalimin e dhunës në shkollë dhe raportimin periodik të çdo shkolle në ZVAP/DRAP/AKAP dhe në MAS;

xh) Mësimin e gjuhëve të huaja në arsimin bazë:

i. të sigurohet vijimësia brenda shkollës e gjuhës angleze, të nisur në klasën I të arsimit fillor dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI;

ii. të sigurohet vijimësia brenda shkollës e gjuhës së huaj (frënge, italiane, gjermane) të nisur në klasën III të arsimit fillor, sipas marrëveshjeve dypalëshe të MAS-it me ambasadat përkatëse;

iii. të zbatohen memorandumet dhe marrëveshjet dypalëshe si vijon:

iii.1 për gjuhën italiane, vijon zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar më 18.5.2021 për programin “Iliria”. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane është kompetencë dhe përgjegjësi e ZVAP-ve;

iii.2 për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe Memorandumit të Partneritetit mbi “Bashkëpunimin Arsimor të Kuadrit Strategjik të Frankofonisë”;

iii.3 ZVAP-et Elbasan, Durrës, Korçë–Pustec, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane, të sigurojnë hapjen e klasave në shkollat e përcaktuara në memorandumet, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët për fazën tranzitore;

iii.4 DRAP-të, për çdo ZVAP në varësi, të raportojnë planifikimin për secilën gjuhë të huaj në AKAP, e cila, brenda datës 30 shtator 2025, raporton në MAS;

y) Zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe raportimin çdo vit nga AKAP-ja në MAS për ecurinë e kësaj nisme;

z) Zbatimin e Programit “Art dhe zeje” në shkollat që janë pjesë e programit, monitorimin sipas



orëve të caktuara nga drejtoria e shkollës të moduleve për çdo veprimtari të programit, duke organizuar aktivitete promovuese nga nxënësit dhe mësuesit apo specialistët e fushës.

zh) Sporti në shkolla.

1. Zbatimi i Programit të Ekipeve Sportive në Shkolla në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), pjesëmarrja aktive dhe angazhimi i nxënësve në Kampionatin Vjetor të Ekipeve Sportive.

2. Krijimi i klasave të profilizuara në sport:

i. klasat e profilizuara në sport krijohen në disiplina të përcaktuara, si: atletikë, gjimnastikë, basketboll, volejbol, futboll, judo, si dhe në disiplina të tjera sportive, në varësi të interesit dhe kërkesave të nxënësve.

ii. këto klasa hapen vetëm në fillim të vitit shkollor dhe vetëm pas miratimit nga DRAP-i përkatës.

iii. drejtuesit e ZVAP-it paraqesin kërkesë pranë DRAP-it për hapjen e klasave të profilizuara në sport, vetëm nëse shkolla përmbush kriteret e mëposhtme:

iii.1 plotëson kushtet e nevojshme të infrastrukturës dhe pajisjeve sportive, në përputhje me kërkesat specifike të disiplinës përkatëse;

iii.2 ka në dispozicion kapacitete profesionale të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor në profilet sportive përkatëse.

Neni 7

Përdorimi i laboratorëve *smart* në institucionet e arsimit bazë

1. Në institucionet e arsimit bazë që janë të pajisura me laboratorë *smart*, drejtuesit e IAP-ve kanë për detyrë të sigurojnë përdorimin e tyre në funksion të përmirësimit të procesit mësimor për të gjithë nxënësit për:

a) Zhvillimin e orës mësimore të lëndës “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” për të gjitha klasat nga e para deri në të nëntën sipas një kalendari të mirëorganizuar nga drejtoria për përdorimin efektiv të laboratorëve *smart* nën kujdesin e përgjegjës të përcaktuar nga drejtoria e shkollës;

b) Zbatimin e metodave bashkëkohore, interaktive dhe të bazuara në simulime për mësimdhënie dhe nxënie, veçanërisht në lëndët e shkencave të natyrës dhe matematikës me qëllim

përvetësimin e koncepteve abstrakte përmes eksperiencave vizuale, eksperimentale dhe digjitale që nxisin mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve.

c) Kalendari i përdorimit të laboratorëve *smart* të hartohet në mënyrë të strukturuar çdo periudhë mësimore, duke e vendosur në funksion të plotë të lëndës së TIK-ut për të gjithë klasat si dhe përdorimin me eficiencë edhe nga mësuesit e tjerë sipas temave të caktuara, për lëndët STEM, gjuhë e huaj apo lëndët shoqërore, si edhe për projekte shkollë, ndërdisiplinore sipas planeve të miratuara nga ekipet lëndore në koordinim me drejtorinë e shkollës. Kalendari i përdorimit të laboratorëve *smart* monitorohen nga ZVAP-të dhe DRAP-et.

2. Mësuesit e lëndës TIK koordinojnë dhe mbështesin mësuesit e lëndëve të tjera në përdorimin efektiv të laboratorit *smart*, me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe zbatimin e mësimdhënies digjitale.

3. DRAP/ZVAP monitorojnë në mënyrë periodike përdorimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve *smart*, për të siguruar zbatimin e metodave interaktive dhe të mësimdhënies përmes platformave *online* nga mësuesit, të referuara nga ASCAP-i dhe drejtoria e shkollës.

4. Përdorimi dhe funksionimi i laboratorëve *smart* raportohet çdo katërmujor nga drejtuesit e IA-ve në ZVAP-et përkatëse, sipas një formati të miratuar nga DRAP-i.

Neni 8

Arsimi i mesëm i lartë

1. Për gjimnazet, DRAP/ZVAP-të dhe drejtuesit e gjimnazeve të sigurojnë:

a) Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të jashtëm dhe të brendshëm për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, të cilat nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të ri dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) Zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

c) Të zbatojnë rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe udhëzimin e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe



Inovacionit nr. 28, datë 16.10.2023, “Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas”, i ndryshuar;

c) Zbatimin e planeve mësimore si më poshtë:

i. Planin mësimor i gjimnazit, i miratuar me shkresën nr. 12789/1 prot., datë 28.12.2017;

ii. Planin mësimor i gjimnazit me kohë të pjesshme, i miratuar me shkresën nr. 7380 prot., datë 20.7.2016;

iii. Planin mësimor për arsimin e mesëm të lartë të orientuar “Teknologji dhe TIK” për nxënësit që nuk dëgjojnë, miratuar me urdhrin nr. 113, datë 27.2.2023, i ndryshuar;

d) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Koordinimin, në zbatim të Marrëveshjes 101143052 – e-Twinning NSO AL ndërmjet MAS-it dhe Komisionit Evropian, për zbatimin e programit *e-twinning*, programit Erasmus+ për arsim dhe edukim;

e) Regjistrimin me përparësi të nxënësve nga pakica kombëtare rome dhe egjiptiane dhe përfundimin prej tyre të arsimit të mesëm të lartë;

ë) Raportimin në AKAP dhe MAS brenda afateve dhe kërkesave të të dhënave statistikore në gjimnaze, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i;

f) Zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore bazuar në rregulloren e Maturës Shtetërore 2025 dhe udhëzimet përkatëse.

2. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me orientim gjuhësor të merren masat e mëposhtme:

a) të zbatojnë planin mësimor të miratuar me shkresën nr. 5415 prot., datë 26.5.2016.

b) t’i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato që janë në katalogun e teksteve shkollore 2024–2025, nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.

3. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me orientim artistik dhe sportiv të merren masat për zbatimin e planeve mësimore dhe programeve lëndore të mëposhtme:

a) Planin mësimor për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me drejtim artistik, miratuar me urdhrin nr. 306, datë 16.6.2023;

b) Planin mësimor për arsimin e mesëm të orientuar me drejtim sportiv, shkolla “Loro Boriçi”,

i miratuar me shkresën nr. 5418 prot., datë 26.5.2016;

c) Planin mësimor për arsimin e mesëm të orientuar me drejtim sportiv, shkolla “Benardina Qerraxhia”, i miratuar me shkresën nr. 4116/1 prot., datë 11.9.2020;

d) Planin mësimor për klasat 6–9, të arsimit të mesëm të ulët, të shkollës me status të veçantë “Benardina Qerraxhia” Durrës”, 2025;

e) Programet lëndore të arsimit të mesëm të ulët, të shkollës me status të veçantë “Benardina Qerraxhia” Durrës”, 2025.

4. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me seksione shkollore dygjuhëshe të merren masat për zbatimin e akteve të mëposhtme:

a) Marrëveshjen nr. 6045 prot., datë 13.6.2016, të lidhur midis ministrisë përgjegjëse për arsimin të Republikës së Shqipërisë dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe zhvillimin ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi “Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh”.

b) Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi programin “Iliria” për mësimin e Gjuhës Italiane në Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruar më 18.5.2021.

c) Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë, mbi seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman dhe planet mësimore për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman.

5. Për institucionet e arsimit të mesëm profesional të zbatohen:

a) Fusha e kulturës profesionale në arsimin e mesëm profesional, për vitin shkollor 2025–2026, rregullohet me akte të posaçme në përputhje ligjin nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b) Për Maturën Shtetërore Profesionale të zbatohet rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, përfshirë dhe Maturën Shtetërore Profesionale dhe udhëzimet përkatëse, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin



dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

Neni 9

Arsimi parauniversitar privat

1. DRAP/ZVAP-të të realizojnë me përparësi detyrat si vijon:

a) të mbajnë kontakte me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor në fushën e arsimit dhe t'i monitorojnë për realizimin e planeve dhe të programeve mësimore;

b) të kërkojnë dhe të administrojnë të dhëna statistikore që lidhen me procesin mësimor;

c) të bëjnë vlerësimin e kriterëve të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS;

ç) të sistemojnë nxënësit, në rast mbylljeje të institucioneve arsimore private.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private të marrin masat e mëposhtme:

a) Të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.

b) Të zbatojnë rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe udhëzimin e përbashkët i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 28, datë 16.10.2023, "Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas", i ndryshuar.

c) Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar.

ç) Institucionet mund ta ndërpresin veprimtarinë e tyre arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë arsimore duhet të njoftojnë institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për

arsimin parauniversitar, AKAP-në, MAS-in, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e plotë në ZVAP-të përkatëse.

3. Institucionet arsimore parauniversitare private që funksionojnë në gjuhë të huaj, të bashkëpunojnë me ZVAP-të përkatëse për njoftimin në kohë të maturantëve të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e procedurave të përcaktuara në rregulloren e Maturës Shtetërore të vitit përkatës. Për maturantët që dëshirojnë të vijojnë studimet e larta jashtë vendit, të bashkëpunojnë me përfaqësitë e huaja të shtetit përkatës për njohjen e kriterëve të aplikimeve në institucionet e huaja të arsimit të lartë.

Neni 10

Dokumentimi i planeve dhe i rregullores së shkollës përmes SMIP-it

1. Drejtori i shkollës ngarkon në SMIP, në hapësirën e dedikuar, planin afatmesëm të shkollës, planin vjetor të veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore të shkollës, rregulloren e brendshme, planin e zhvillimit profesional dhe çdo dokument tjetër të përcaktuar në këtë udhëzim, brenda muajit nëntor të vitit mësimor.

2. Psikologu, punonjësi social dhe oficeri i sigurisë ngarkojnë në SMIP planet vjetore të punës dhe dokumentet përkatëse, brenda muajit tetor të vitit mësimor.

3. Koordinator i cilësisë dhe koordinatori i karrierës ngarkojnë në SMIP planet vjetore të punës dhe dokumentet përkatëse, brenda muajit tetor të vitit mësimor.

4. Mësuesit ngarkojnë në SMIP planet vjetore dhe dokumentet e kërkuara nga drejtoria, brenda muajit shtator të vitit mësimor.

KREU III

POLITIKA, STRATEGJI, MARRËVESHJE

Neni 11

Reduktimi i braktisjes shkollore

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të zbatojnë me përgjegjësi:



a) Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet MAS-it, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministrisë së Brendshme (MB), nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”;

b) Urdhrin e përbashkët të MAS-it, MB-së dhe MSHMS-së nr. 292, datë 28.5.2019, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive ‘Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollore’”.

2. Drejtoritë e shkollave raportojnë në mënyrë të detajuar mbi rastet e braktisjes apo atyre në rrezik braktisje të shkollës nga nxënësi. Ky raportim bëhet pasi kanë marrë informacion nga prindi ose personi që ushtron të drejtën prindërore dhe nga njësia administrative për arsyet e braktisjes apo rrezikut të braktisjes dhe masat e marra për parandalimin. Çdo rast raportohet menjëherë në ZVAP dhe vihet në dijeni dhe njësia administrative në bashkinë përkatëse për ndjekjen e përbashkët dhe adresimin në strukturat përgjegjëse, çdo fund viti shkollore.

3. Drejtoritë e shkollave të evidentojnë dhe të raportojnë dhe rastet e transferimeve nga një shkollë në një tjetër apo largimit të nxënësve për arsye të ndryshimit të vendbanimit të familjes, duke i klasifikuar në një kategori të veçantë dhe raportuar në ZVAP, çdo fund viti shkollore.

4. ZVAP-të kanë këto detyra:

a) të monitorojnë shkollat lidhur me raportimin e nxënësve braktisës dhe të atyre në rrezik braktisje, sipas kalendarit të miratuar nga AKAP-i;

b) të trajnojnë drejtuesit e shkollave për raportimin në kohë të rasteve të braktisjes apo riskut të braktisjes së shkollës nga nxënësit dhe protokollet e ndjekjes në rastet kur konstatohet braktisja;

c) të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe organizatave të shoqërisë civile, për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;

ç) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngjuar apo të strehuar pranë institucioneve që bëjnë pjesë në Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik dhe të zbatojnë procedurat e ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;

d) të raportojnë në DRAP punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore, sipas kalendarit të miratuar nga AKAP-i. DRAP-të të raportojnë në AKAP, e cila përcjell raportin në MAS çdo fund viti dhe sa herë është e nevojshme.

Neni 12

Zhvillimi profesional dhe portofoli digjital i mësuesit

1. Drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare të ndjekin me përparësi plotësimin në SMIP të portofolit digjital nga të gjithë mësuesit.

2. Mësuesit të ngarkojnë në portofolin digjital në SMIP të gjitha certifikatat, trajnimet, konferencat, kreditet e fituara, pjesëmarrjet në aktivitete të certifikuara, kualifikimet profesionale, etj. Ky proces të përmbyllet brenda muajit tetor të vitit mësimor.

3. Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore të zbatojnë urdhrin nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, dhe çdo urdhër që do të dalë në vijim të vitit shkollore.

4. Drejtori i shkollës dhe mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të hartojnë Planin e Zhvillimit Profesional trevjeçar për mësuesit e shkollës, dhe vlerësimin individual të nevojave për trajnim për mësuesit, të identifikuar nga monitorimi periodik i kryer dhe nevoja për trajnim për mësuesit, i cili duhet të përcillet përmes SMIP-it në ZVAP, AKAP-ja dhe ASCAP-ja. Këto institucione duhet të përgatisin kalendarin e trajnimeve për planifikimin e tyre në programin e zhvillimit profesional të mësuesve të hartuar dhe zhvilluar nga ASCAP-ja.

5. Drejtori i shkollës kujdeset që në bashkëpunim me nëndrejtorin/ët në shkollë, me mësuesit koordinatorë të cilësisë dhe mësuesit lëndorë të përdorin SMIP për të monitoruar ecurinë e zhvillimit profesional përmes portofolit digjital të mësuesit ku duhet të figurojnë çdo vit dhe sa herë është e nevojshme informacionet për zhvillimin profesional të mësuesit sipas standardeve të përcaktuara nga MAS-i dhe ASCAP-ja.

6. AKAP-ja përmes DRAP/ZVAP-të:

a) Bashkëpunojnë me drejtoritë e shkollave dhe mësuesit koordinatorë të cilësisë për të planifikuar



nevojën për trajnime që nevojitet për mësuesit sipas lëndëve dhe nivelit arsimor dhe i përcjellin në ASCAP për të realizuar trajnimet sipas nevojave të evidentuara bazuar në Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve në bashkëpunim me ASCAP-në dhe IAL-të.

b) Monitorojnë plotësimin e portofolit digjital të mësuesit në SMIP në çdo shkollë dhe kujdesen që trajnimet e planifikuara nga ASCAP-ja të përputhen me nevojat e dala nga planet e vlerësimit të zhvillimit profesional të shkollës dhe inspektimet e kryera nga ZVAP-i, në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kualifikimit të vazhdueshëm të mësuesve si pjesë e Planit të Zhvillimit Profesional të hartuar nga ASCAP-ja dhe ndjekur nga AKAP-i.

7. DRAP/ZVAP-të:

a) Publikojnë në faqen e internetit listën e institucioneve arsimore parauniversitare, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale.

b) Hartojnë listat e IAP-ve, publike dhe/ose private, në juridiksion të tyre, në të cilat do të zhvillohet praktika profesionale, listat e praktikantëve dhe listat e mentorëve.

c) Sigurojnë kryerjen e praktikës profesionale nga praktikantët, sipas procedurave të rregullores së praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

d) Monitorojnë organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në IAP.

Neni 13

Shkolla qendër komunitare

1. Konsolidimi i shkollave qendra komunitare (SHQK), bazuar në standardet e shkollës si qendër komunitare në këto aspekte:

a) SHQK-të të vlerësohen për përmbushjen e standardeve dhe kritereve të përcaktuara për SHQK-në;

b) shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët Save the Children, World Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e SHQK-së dhe të bashkëpunohet për përmbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:

a) të vlerësojnë shkollat qendër komunitare në përputhje me kriteret;

b) të marrin masat e nevojshme për këshillimin, informimin, trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe partnerët;

c) të trajnojnë dhe të rritin kapacitetet e mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ASCAP-in dhe partnerët;

ç) të promovojnë praktikat më të mira të SHQK-ve dhe të shkëmbejnë përvojat mes shkollave;

d) të marrin masat për menaxhimin sa më efektiv të 10 orëve javore të planifikuara për SHQK-në;

e) të propozojnë në MAS për miratim shkolla të tjera që plotësojnë kriteret e SHQK-së.

Neni 14

Karta e Performancës

1. Për Kartën e Performancës të vitit shkollor 2024–2025 dhe vitit shkollor 2025–2026:

a) shkollat të llogarisin edhe ndryshimet në vlerë për treguesit e pasqyruar një vit më parë;

b) në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në udhëzuesin për Kartën e Performancës së shkollës;

c) institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo (p.sh., të dhëna për lëndët me zgjedhje, arritjet e nxënësve me AK etj.;

ç) çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 3.9.2025, të plotësojë Kartën e Performancës së shkollës për vitin shkollor 2024–2025, si dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin;

d) ZVAP-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.9.2025;

dh) në fund të muajit shtator 2025, ZVAP-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;

e) shkollat të hartojnë Kartën e Performancës për vitin shkollor 2025–2026 me treguesit e përzgjedhur, bazuar në urdhrin nr. 157, datë 28.3.2022;

ë) çdo shkollë e arsimit parauniversitar të llogarisë edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës të vitit paraardhës.



Neni 15

Parandalimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore

1. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të marrin masa për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit “Për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi dhe rritjen e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare”, miratuar me urdhrin nr. 32, datë 21.1.2025, duke ndjekur me përparësi:

a) zbatimin e Kodit të Etikës së mësuesit, gusht 2025;

b) planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuese me fokus parandalimin dhe minimizimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore;

c) ngritjen e këndit “Stop dhunës në shkollë”;

ç) ngritjen e ekupeve “antibulling” në çdo shkollë;

d) monitorimin dhe përmirësimin e punës së komisioneve të disiplinës dhe të komisioneve të etikës dhe të sjelljes, për trajtimin e rasteve të çdo lloji dhune në institucionet arsimore,

dh) organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuese të datës 21 nëntor, Ditës Kombëtare kundër Bullizmit;

e) konsolidimin e rrjetit të mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar;

ë) raportimin në DRAP, brenda datës 30.5.2026, sipas formateve të përcaktuara, të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuara nga komisionet e etikës, si dhe raportin informues për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

2. AKAP-ja harton raportin përmbledhës të marrë nga DRAP-të dhe e dërgon në MAS, brenda datës 1.7.2026.

Neni 16

Zbatimi i strategjive ndërsektoriale, planeve kombëtare të veprimit dhe projekteve

1. AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndërsektoriale:

a) të caktojnë personat përgjegjës,

b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;

c) të monitorojnë realizimin e veprimtarive,

ç) të raportojnë rregullisht për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të mbështesin dhe raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS, ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre, për strategjitë, planet kombëtare dhe projektet e mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021;

b) Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, plani i veprimit dhe pasaporta e indikatorëve, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 27.12.2022;

c) Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1137, datë 16.12.2020;

ç) Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe plani i veprimit 2020–2025, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1034, datë 24.12.2020;

d) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 3.11.2021;

dh) Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.12.2020;

e) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021;

ë) Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020;

f) Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 24.12.2019;

g) Plan Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 12.5.2021;

gj) Plan Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021–2025,



miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 18.11.2021;

h) Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 19.6.2019;

i) Programi “Art dhe zeje” në shkollat që janë pjesë e programit dhe monitorimin sipas orëve të caktuara nga drejtoria e shkollës të moduleve për çdo veprimtari të programit dhe nxënësve përfitues dhe duke organizuar aktivitetet promovuese nga nxënësit dhe mësuesit apo specialistët e fushës;

j) Programi i Ekipeve Sportive në Shkolla me Komitetin Olimpik Shqiptar, dhe pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e nxënësve të shkollave në Kampionatin Vjetor të Ekipeve Sportive;

k) Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Ky projekt do të zbatohet në shkollat e përzgjedhura në bashkëpunim nga Këshilli i Evropës dhe MAS-i;

l) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për zbatimin e projektit “Element IT”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 594, datë 7.9.2022;

m) Projekti “Shkollat për shëndetin”, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 18.9.2021;

n) Projekti “QËNDRO” (Qëndroni në shkollë! Qëndroni në Shqipëri), në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë italiane dhe UNICEF Shqipëri;

ll) Projekti “Panairi shkencor”, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar midis MAS-it dhe SHUKALB-it;

o) Projekti “Inteligjenca artificiale për të rinjtë”, në përputhje me memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet MAS-it dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, me nr. 3877/1 prot., datë 3.6.2022.

Neni 17

Edukimi shëndetësor dhe mjedisor

1. DRAP/ZVAP dhe IAP-të të marrin masa për zbatimin me përparësi të:

a) Urdhrit të përbashkët nr. 335, datë 14.7.2021, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratimin e rregullores “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.

b) Urdhrit të përbashkët nr. 336, datë 14.7.2021, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.

2. DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore parauniversitare të sigurojnë:

a) Informimin dhe angazhimin e institucioneve arsimore për të lehtësuar procesin e trajnimit të mësuesve të Shkencave të natyrës, “Edukimit qytetar” dhe “Edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit” në AF, AMU dhe AML, duke synuar rritjen e kapaciteteve mësimore në fushat e edukimit shëndetësor, mjedisor dhe qytetar;

b) Nxitjen e një jetese të shëndetshme dhe ndërgjegjësimin mjedisor të nxënësve përmes veprimtarive edukative dhe jashtëshkollore;

c) Zbatimin e programit “Art zeje dhe sport” në shkollat që janë pjesë e programit dhe monitorimin sipas orëve të caktuara nga drejtoria e shkollës të moduleve për çdo veprimtari të programit dhe nxënësve përfitues dhe duke organizuar aktivitetet promovuese nga nxënësit dhe mësuesit apo specialistët e fushës;

ç) Zbatimin e Programit të Ekipeve Sportive në Shkolla, dhe pjesëmarrjen aktive në përgatitjen dhe në angazhimin e nxënësve të shkollave në Kampionatin Vjetor të Ekipeve Sportive;

d) Zbatimin e qasjes ndërdisiplinore STEM për të formuar nxënës të ndërgjegjshëm, aktivë dhe të përgatitur për sfidat e shëndetit dhe të mjedisit në shekullin XXI;

dh) Zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore dhe plotësuese në institucionet arsimore parauniversitare në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, Ditës Botërore të Ujit dhe Ditës Botërore të Tokës;

e) Zbatimin e nismës “Toka në shkollë” për krijimin në të gjitha shkollat të miniparcelave (kopshte të gjelbra në shkollë);

ë) Zbatimin e projekteve “Miqte e ujit” dhe “Sfida botërore e monitorimit të ujit”, në përputhje



me marrëveshjet e nënshkruara midis MAS-it dhe SHUKALB-it.

Neni 18

Zbatimi i marrëveshjeve dhe memorandumëve

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS, për ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për marrëveshjet dhe memorandumet e mëposhtme:

a) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1084 prot., datë 15.2.2023 ndërmjet MAS-it dhe Institutit për Studimin e Krimeve të Komunizmit, “Për koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizmit të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1944–1990”.

b) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1646 prot., datë 18.3.2021 ndërmjet MAS-it dhe Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të zbatimit të politikave arsimore dhe të formimit historik të nxënësve.

c) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4661/1, datë 18.6.2015, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të shahut në shkollë”.

ç) Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 1988/2, datë 14 prill 2021 ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Albanian-American Development Foundation për zbatimin e programeve të “Junior Achievement of Albania”. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të koordinojë veprimtaritë që mundëson ky memorandum, duke u angazhuar në mbështetje të ekspertëve vendas dhe të huaj, të cilët do të zbatojnë aktivitetet e programeve të “Junior Achievement of Albania”.

d) Marrëveshja e Bashkëpunimit për Këshillimin e Karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar nr. 2996/2, datë 5.5.2022, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë. Për vitin shkollor 2025–2026 marrëveshja do të vazhdojë të zbatohet në institucionet e arsimit parauniversitar në juridiksionin e ZVAP Tiranë. AKAP në bashkëpunim me ZVAP Tiranë, të koordinojë veprimtaritë që mundëson kjo marrëveshje, duke mbështetur ekspertët e zyrës së këshillimit të

karrierës, pranë Bashkisë Tiranë, në zbatim të planit të aktiviteteve.

dh) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 9322, datë 12.11.2015 për zbatimin e projektit “Mësime të xhudos në shkollë”.

e) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4073, datë 18.4.2016, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të hendbollit në shkollë”.

ë) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 1660, datë 12.12.2017, për zbatimin e projektit “Mësime të futbollit në shkollë (Growth 2020)”.

f) Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Organizatës Kombëtare Antidoping dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, regjistruar në MAS me nr. 1155/1, datë 29.5.2023, për zbatimin e projektit “Ngritja e kapaciteteve për ndërgjegjësimin dhe edukimin antidoping në shkollë”, për edukimin e të rinjve me parimet e *fair play* (garim i drejtë) dhe rreziqet e dopingut ndaj shëndetit, dëmi që shkakton ai në vlerat etike të sportit, në zbatim të ligjit nr. 9242 datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping 1989”.

g) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2028/1, datë 23.2.2018, për zbatimin e projektit “Mësime të basketbollit në shkollë”.

gj) Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 “Për edukimin përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë kulturore, artistike, figurative që mundëson ky memorandum.

h) Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet MAS-it dhe UNFPA (2022–2026), datë 27.4.2022, nr. 412 prot., të konsiderohet me përparësi programi i edukimit shëndetësor me fokus: “Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor”. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore të lehtësojnë procesin e trajnimit të mësuesve të arsimit fillor (klasa IV–V) dhe të lëndëve “Biologji”, “Edukim qytetar”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, në



arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimi e mesëm të lartë (AML).

i) Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për edukimin patriotik dhe atdhetar të të rinjve në kuadër të programit “Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura”, me nr. 5666/2 prot., datë 6.9.2024.

j) Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Divjakë për të zbatuar projektin pilot të përfshirjes së Bashkisë në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar për institucionet arsimore parauniversitare që janë në territorin e saj.

k) Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Berat për të zbatuar projektin pilot të përfshirjes së Bashkisë në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar për institucionet arsimore parauniversitare që janë në territorin e saj, nr. 6665 prot., datë 22.10.2024.

l) Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Shkodër për të zbatuar projektin pilot të përfshirjes së Bashkisë në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar për institucionet arsimore parauniversitare që janë në territorin e saj, nr. 6667 prot., datë 22.10.2024.

ll) Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Kolonjë për të zbatuar projektin pilot të përfshirjes së Bashkisë në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar për institucionet arsimore parauniversitare që janë në territorin e saj, nr. 6666 prot., datë 22.10.2024.

m) Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Korpusit të Pages, datë 23.4.2024. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore që:

i. të përfshijnë vullnetarin/en në takimet e organizuara në shkollë për procesin e bashkë-mësimdhënies dhe të projekteve të ndryshme në interes të shkollës,

ii. të mbështesin mësuesit të marrin pjesë në trajnimet që zhvillon/sponsorizon Korpusi i Pages,

iii. të përfshijnë vullnetarin/en në organizimin dhe zbatimin e veprimtarive dhe të projekteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet,

iv. të mbështesin vullnetarin/en në zbatimin e nismës për të zhvilluar aftësitë në gjuhën angleze të mësuesve të lëndëve të tjera.

Neni 19

Veprimtari plotësuese dhe jashtëshkollore

Në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, ZVAP-të dhe institucionet arsimore të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:

1. Olimpiadat kombëtare në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.

2. Olimpiadën e përbashkët me Kosovën për Gjuhën Shqipe, klasa e 9-të.

3. Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe për klasat IX.

4. Konkursin Kombëtar të Teatrit, për AMU-në.

5. Organizimin për herë të parë të Festivalit të Shkencës për AML, lidhur me projektet e shkencës dhe teknologjisë.

6. Pajisjen me “Medaljen e artë”, të nxënësve të shkëlqyer në vite, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitin shkollor 2024–2025.

7. Kampionatin e basketbollit dhe volejbollit me KOKSH në kuadër të Programit të Ekipeve Sportive në Shkollë.

8. Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars–prill 2026.

9. Java Evropiane e Sportit, 23–30 shtator 2025.

10. Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2025.

11. Dita Botërore e Gjuhës Rome, UNESCO, 5 nëntor 2025.

12. Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2025.

13. Dita e Luftës kundër Bullizmit, 21 nëntor 2025.

14. Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, 3 dhjetor 2025.

15. Dita e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, 10 dhjetor 2025.

16. Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve, UNESCO, 18 dhjetor 2025.

17. Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2026.



18. Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2026.

19. Dita Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2026.

20. Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2026.

21. Dita Botërore e Librit, 23 prill 2026.

22. Java Olimpikë (prill–maj 2026).

23. Dita Ndërkombëtare e *Twining*, 7 maj 2026.

24. Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2026.

25. Dita Evropiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2026.

26. Dita Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, 24 janar 2026.

27. Dita Ndërkombëtare e Matematikës, UNESCO, 14 mars 2026.

28. Dita Botërore e Poezisë, UNESCO, 21 mars 2026.

29. Dita Botërore e Ujit, UNESCO, 22 mars 2026.

30. Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, UNESCO, 16 maj 2026.

31. Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim, UNESCO, 21 maj 2026.

32. Dita Botërore e Mjedisit, UNESCO, 5 qershor 2026.

33. Dita Ndërkombëtare e Rinisë, UNESCO, 12 gusht 2026.

34. Kalendar i Ditëve të Evropës dhe veprimtaritë gjithëvjetoje për njohjen e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

35. Konkursët në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me tematikë “Të njohim Evropën”.

36. Java Evropiane e Lëvizjes “*Now we move*”.

37. Ditët e festave kombëtare.

38. Në kuadër të vitit evropian të edukimit për qytetarinë digjitale (2025), më 16 nëntor të zhvillohen aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuëse në të gjitha institucionet arsimore.

39. Aktivitete për data dhe ngjarje të shënuara në nivel rajonal dhe lokal.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Institucionet që ngarkohen për marrjen e masave dhe zbatimin e këtij udhëzimi

1. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore parauniversitare, për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrim masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor parauniversitar dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu

MINISTËR I
EKONOMISË KULTURËS
DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

SHTOJCË NR. 1 PLANI MËSIMOR I ARSIMIT BAZË PËR KLASAT VI–IX

FUSHA/LËNDËT	KLASAT			
	VI	VII	VIII	IX
KURRIKULA BËRTHAMË				
GJUHET DHE KOMUNIKIMI	8	8	8	8
GJUHË SHQIPE	5	5	5	5
GJUHË E HUAJ E PARË	3	3	3	3
MATEMATIKË	4	4	4	4
SHKENCAT E NATYRËS	2	4	6	6
Dituri natyre				
Fizikë	1	2	2	2
Kimi			2	2
Biologji	1	2	2	2
SHOQËRIA DHE MJEDISI	3	5	5	5
Edukim për shoqërinë				
Qytetari	1	1	1	1
Histori	1	2	2	2
Gjeografi	1	2	2	2
ARTE	3	2	2	2
Muzikë	1	1	1	1
Art pamor	1	1	1	1
Kërcim				
Teatër	1			
EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3	3
TEKNOLOGJI DHE TIK	2	1	1	1
TIK	1	1	1	1
Aftësi teknologjik praktik	1			
KURRIKULA ME ZGJEDHJE	2	2	2	2
Totali (orë javore)	27	29	31	31



URDHËR

Nr. 804, datë 14.8.2025

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË
MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE
VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË
TJERË, NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) në pjesën C të shtojcës 1, pas rreshtit 52 shtohet rreshti 53, duke miratuar për shtim 1 (një) lëndë vepruese me risk të ulët, sipas pikës 1 të shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri;

b) në pjesën D të shtojcës 1, pas rreshtit 14 shtohet rreshti 15 me 1 (një) lëndë vepruese kandidate për zëvendësim, sipas pikës 2 të shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri;

c) në pjesën A dhe D të shtojcës 1, bëhen zgjatjet e afateve të regjistrimit për 18 (tetëmbëdhjet) lëndë vepruese, sipas pikës 3 të shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) në pjesën A të shtojcës 1, rreshtat 67 dhe 81 zëvendësohen sipas pikës 4 të shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri;

d) në pjesën A të shtojcës 1, rreshti 167, 8-hydroxyquinoline, fshihet, sipas pikës 5 të shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përditësimi sipas shkronjës “c” të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Arian Jaupllari

SHTOJCA 1

1. Në pjesën C të shtojcës 1, pas rreshtit 52 shtohet rreshti 53, me përmbajtjen si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm, numri i identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
53.	Lysate of <i>Willaertia magna</i>	Nuk aplikohet	Nuk ka papastërti të rëndësishme	7 korrik 2025	7 korrik 2040	Për zbatimin e parimeve uniforme, duhet të merren parasysh përfundimet e raportit të rishikimit për <i>lysate of Willaertia magna</i> . Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t'i kushtohet veçanërisht vëmendje: - garancisë nga ana e prodhuesit për ruajtjen rigorozë të kushteve mjedisore dhe analizës së kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, me qëllim sigurimin e respektimit të kufijve të



						ndotjes mikrobiologjike, siç përcaktohen në Dokumentin OECD mbi Kufijtë e Ndotësve Mikrobiologjikë për Produktet Mikrobiale për Kontrollin e Dëmtuesve. - pezullueshmërisë së PMB-ve që përmbajnë lysate of <i>Williaertia magna</i>, të cilat mund të kërkojnë përzierje të vazhdueshme gjatë mbushjes dhe përdorimit të tyre. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e riskut, kur është e nevojshme.
--	--	--	--	--	--	--

2. Në pjesën D, të shtojcës 1, pas rreshtit 14 shtohet rreshti 15, me përmbajtjen si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm, numri i identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
15.	<i>Quinolin-8-ol</i> CAS No: 148-24-3 CIPAC No: 677	Quinolin-8-ol	≥ 990 g/kg	1 korrik 2025	30 qershor 2032	Lejohen vetëm përdorimet me ujë me pika nga përdorues profesionistë në serat e përhershme që lejojnë shkëmbimin e kontrolluar të materialeve dhe energjisë me mjedisin dhe parandalojnë lëshimin e PMB-ve në ambient. Lejet duhet të jepen vetëm për përdorime ku ekziston një sistem i mbyllur transferimi për mbushjen dhe përzierjen e PMB-se në pajisjet e aplikimit. Duhet respektuar një periudhë para vjeljes prej të paktën 22 ditësh pas aplikimit të fundit dhe, toka në të cilën kultivohen bimët në serat e përhershme nuk duhet të përdoret përsëri jashtë serës brenda 1 viti pas aplikimit të fundit. Për zbatimin e parimeve uniforme, duhet të merren parasysh përfundimet e raportit të rinovimit për <i>quinolin-8-ol</i>. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë pajisjeve personale mbrojtëse të nevojshme për operatorët dhe punonjësit. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e riskut, kur është e nevojshme.



						Kërkuesi duhet të dorëzojë informacion konfirmues në lidhje me: 1) ekspozimin jodietetik për punonjësit dhe operatorët, në veçanti një studim që shqyrton ekspozimin e punonjësve dhe operatorëve nën kushte reale përdorimi; 2) të dhëna për metabolizmin e qarkullimit bujqësor të kulturave në kushte të kufizuara që adresojnë fatin e komponimit kryesor në kulturat pasuese; 3) studime ose informacione për të konfirmuar mungesën e potencialit klastogjenik dhe anuegjentik të <i>quinolin-8-ol</i>.
--	--	--	--	--	--	---

3. Në pjesën A dhe D të shtojcës 1, në kolonën 6 “Skadimi i miratimit”, bëhen zgjatjet e afateve të regjistrimit, si vijon:

3.1 Në pjesën A të shtojcës 1, bëhen ndryshimet si vijon:

- 1) Në rreshtin 6, Pyraclostrobin, data zëvendësohet me “15 shtator 2026”;
- 2) Në rreshtin 12, Daminozide, data zëvendësohet me “15 shtator 2026”;
- 3) Në rreshtin 18, Clodinafop, data zëvendësohet me “31 korrik 2027”;
- 4) Në rreshtin 66, *Beauveria bassiana* shtami ATCC 74040 dhe GHA, data zëvendësohet me “15 shtator 2027”;
- 5) Në rreshtin 133, Buprofezin, data zëvendësohet me “15 dhjetor 2026”;
- 6) Në rreshtin 168, Metam, data zëvendësohet me “15 nëntor 2027”;
- 7) Në rreshtin 172, *Trichoderma asperellum* (shtami T34), data zëvendësohet me “15 tetor 2027”;
- 8) Në rreshtin 174, Cyflumetofen, data zëvendësohet me “15 tetor 2027”;
- 9) Në rreshtin 175, *Trichoderma atroviride* shtami I-1237, data zëvendësohet me “15 tetor 2027”;
- 10) Në rreshtin 176, Ametoctradin, data zëvendësohet me “31 maj 2028”;
- 11) Në rreshtin 177, Mandipropamid, data zëvendësohet me “31 qershor 2029”;
- 12) Në rreshtin 181, *Helicoverpa armigera nucleopolyhedrovirus*, data zëvendësohet me “15 tetor 2027”;
- 13) Në rreshtin 185, *Spodoptera littoralis nucleopolyhedrovirus*, data zëvendësohet me “15 tetor 2027”;
- 14) Në rreshtin 222, *Streptomyces lydicus*, shtami WYEC 108, data zëvendësohet me “30 qershor 2029”;
- 15) Në rreshtin 234, Flupyradifurone, data zëvendësohet me “9 qershor 2029”;
- 16) Në rreshtin 235, Rescalure, data zëvendësohet me “18 maj 2028”;
- 17) Në rreshtin 236, Mandestrobin, data zëvendësohet me “9 qershor 2029”;

3.2 Në pjesën D të shtojcës 1, bëhen ndryshime si vijon:

- 1) Në rreshtin 10, Copper compounds, data zëvendësohet me “30 qershor 2029”.

4. Në pjesën A të shtojcës 1, rreshtat 67 dhe 81 zëvendësohen me përmbajtjen, si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm, Numri identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
67	<i>Trichoderma atroviride</i> (me pare T. harzianum) SHTAMI: T-11	Nuk aplikohet	Nuk ka papastërti të rëndësishme	1 maj 2009	30 nëntor 2026	PJESA A Registrohet vetëm për përdorime si fungicid. PJESA B



	Koleksioni i kulturës: Jo Koleksioni i kulturës spanjolle të llojit CECT 20498, identik me IMI 352941					Për zbatimin e parimeve uniforme, duhet të merren parasysht përfundimet e raportit të rishikimit për <i>Trichoderma</i> <i>atroviride</i> (më parë <i>T.</i> <i>harzianum</i>) T-11 (SANCO/1841/2008). Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë, kur është e nevojshme, masa për zbutjen e riskut.
81	Fatty acids /Acide yndyrore C7 deri C20 CAS No 112-05-0 (Pelargonic acid) CAS No 67701-09-1 (Kripërat e acideve yndyrore C7-C18 dhe C18 të ngopura me kalium) 124-07-2 (Caprylic acid) 334-48-5 (Capric acid) CIPAC No: Nuk është caktuar	Nonanoic acid Caprylic acid, Capric acid (ISO për secilin rast) Octanoic acid, Decanoic acid (IUPAC për secilin rast)	≥ 889 g/kg (Pelargonic Acid) ≥ 838 g/kg fatty acids	1 shtator 2009	1 dhjetor 2026	PJESA A Regjistrohet vetëm për përdorime si insekticid, akaricid, herbicid dhe rregullator i rritjes së bimëve. PJESA B Për zbatimin e parimeve uniforme, duhet të merren parasysht përfundimet e raportit të rishikimit për acide yndyrore (SANCO/2610/2008). Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë, kur është e nevojshme, masa për zbutjen e riskut.

5. Në pjesën A të shtojcës 1, përmbajtja e rreshtit 167, *8-hydroxyquinoline*, fshihet duke mbetur si vijon:

167	8-hydroxyquinoline CAS No 148-24-3 CIPAC No 677	8-quinolin ol	≥ 990 g/kg	1 janar 2012	31 dhjetor 2025	Fshirë
-----	--	---------------	-----------------	--------------	-----------------	--------



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

